



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.203/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Socijaldemokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik, Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Lokale, të mbajtura më 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e BAZUAR ankesa: ZL.Anr.203/2025 e datës 13.10.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Socijaldemokratska Unija (SDU), me seli në Prizren.

II. Subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 500.00Euro (pesëqindë Euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 13.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Socijal Demokratska Unija (SDU), në të cilën pretendon se më datë 12 tetor 2025, në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, kur ishte në fuqi heshtja zgjedhore, në profilin zyrtar në Facebook të Emilijes Redžepi, bartëses së listës dhe kryetares së Nova Demokratska Stranka, u publikua spoti zgjedhor i kësaj partie.

Publikimi përmban ftesë për të votuar dhe mesazhe promovuese politike, me çka është shkelur neni 52 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, i cili ndalon eksplisit çdo lloj propagandë politike gjatë heshtjes zgjedhore.

Më tej në ankesë pretendohet se subjekti politik Nova Demokratska Stranka, përmes kryetares së saj dhe bartëses së listë, ka kryer shkelje të heshtjes zgjedhore dhe të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, me çka është cenuar parimi i barazisë së pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

Në ankesë ka bashkangjitur si dëshmi Screenshot-i i publikimit nga profili në Facebook i Emilije Redžepi, datën dhe orën e saktë të publikimit, linkun e publikimit në fjalë

Kërkojnë nga PZAP-ja që të konstatojë se Nova Demokratska Stranka ka shkelur heshtjen zgjedhore, të shpallë masën përkatëse ligjore ndaj subjektit politik dhe personit përgjegjës, të urdhërojë heqjen e përmbajtjes së diskutueshme nga rrjetet sociale.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik Nova Demokratska Stranka, sqaron se përmbajtja videos së diskutueshme, në të cilën i referohet ankuesja, u publikua për shkak të një gabimi teknik në funksionimin e aplikacionit Facebook. Materiali video fillimisht ishte planifikuar të publikohej pas përfundimit të ditës zgjedhore, domethënë në orët e mbrëmjes së të njëjtës ditë, megjithatë, një gabim sistemi në funksionin "schedule post" çoi në publikim automatik të mëngjesit të ardhshëm, pa pjesëmarrje manuale apo qëllim të përdoruesit të llogarisë.

Më tej në përgjigje theksohet se ky publikim nuk ishte rezultat i një qëllimi për të ndikuar tek votuesit dhe as nuk kishte karakter promocional në momentin e publikimit. Regjistrimet teknike dhe historiku i publikimeve nga platforma Facebook (i cili mund të dorëzohet sipas nevojës) konfirmojnë se përmbajtja ishte përgatitur dhe e planifikuar paraprakisht, por nuk u publikua në mënyrë aktive nga përdoruesi gjatë ditës zgjedhore.

Kandidatja Emilija Redžepi gjatë gjithë procesit zgjedhor ka respektuar dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe vendimet përkatëse të KQZ-së që kanë të bëjnë me ndalimin e propagandës zgjedhore në ditën e zgjedhjeve. Nuk ka pasur qëllim, veprim të koordinuar apo aktivitete që mund të përfaqësonin një formë propagande apo ndikimi të votuesit gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore.

Kërkon nga Paneli, që të hedhë poshtë ankesën si të pabazuar, duke qenë se bëhet fjalë për një gabim teknik jashtë kontrollit të kandidatit, pa element qëllimi apo ndërgjegjësimi për shkeljen e heshtjes zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik NDS, vlerësoj se pretendimet e Subjekti Politik SDU, janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet "Bërja fushatë në çfarëdo mënyre"

Si dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, ku parashihet se Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi.

Në përgjigje në ankesës, të subjektit politik NDS nuk janë kundërshtuar pretendimet ankimore, se kryetarja e këtij subjekti politik njëherit edhe bartëse e listës Emilija Redžepi, në profilin zyrtar në Facebook ka publikuar spotin zgjedhor të kësaj partie duke theksuar se materiali videos fillimisht ishte planifikuar të publikohej pas përfundimit të ditës zgjedhore, domethënë në orët e mbrëmjes së të njëjtës ditë, dhe se publikimi ishte një gabim sistemi në

funkcionin "schedule post" çoi në publikim automatik në ditën e zgjedhjeve pa qëllim të përdoruesit të llogarisë.

Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh *"Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme."* Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e bazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se bartësja e listës Emilija Redžepi, përkatësisht kryetarja e subjektit politik NDS, ka bërë publikimin me datë 12 Tetor 2025, në ditën e votimit.

Paneli ka konsideruar këtë veprim si shkelje të nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, pasi veprimi është bërë në rrjetin social.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se veprimi i përshkruar në ankesën e parashtruar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228 dhe nenit 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores zgjedhore 07/2024, po ashtu fakti Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë ditës së votimit, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i pranoi si të bazuara.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në ditën e votimit. Ndërsa lidhur me pretendimet në përgjigje në ankese se duke theksuar se materiali videos fillimisht ishte planifikuar të publikohej pas përfundimit të ditës zgjedhore, domethënë në orët e mbrëmjes së të njëjtës ditë, dhe se publikimi ishte një gabim teknik në sistem në funksionin "schedule post" çoi në publikim automatik në ditën e zgjedhjeve pa qëllim të përdoruesit të llogarisë. Paneli vlerëson se mos dija lidhur me shkeljen e tillë nuk e liron nga përgjegjësia, kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik NDS, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të votimit.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.203/2025 më datën 15.10.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.

